



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE**

RELACION

“MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN NËPËRMJET KONKURRIMIT TË SUBJEKTIT QË DO TË KRYEJE TRANSPORTIN QYTETËS (URBAN), ME SUBVENCION”

Për kryerjen e transportit qytetës me subvencion Bashkia Korçë në datë 18.06.2018 ka lidhur një kontratë me subjektin “Ortakëria Korça” sh.p.k. ,bazuar kjo në vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 15 datë 09.02.2018 “Mbi përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen nepërmjet konkurrimit të subjektit qe do të kryeje transportin qytetes (urban) në katër linjat e Bashkisë Korçë, me subvencionim”.

Meqenese kontrata e sipërpërmendur përfundon pas kalimit të afatit 5 vjeçar pra në 18.06.2023 lind nevoja që të zhvillohet procedura e konkurrimit për këtë shërbim.

Bazuar ne nenin 23 pika 6 dhe 54 gërma k të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, në ligjin Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar i cili në nenin 14 të tij shprehet **“Këshilli i Bashkisë duke u mbështetur në nevojat e popullsisë për transportin qytetës, përcakton linjat, organizon, financon dhe vendos për këtë lloj transporti brenda juridiksionit të vet. Transporti qytetës kryhet vetëm me autobuzë nga shoqëritë të cilat e kanë të shprehur në aktet e themelimit si objekt të veprimtarisë, veprimtarinë e transportit të udhëtarëve, VKM Nr. 325 dt 19.03.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve si dhe për njohjen e dokumantave zyrtarë të caktuara për këta operatorë”** I ndryshuar si dhe udhëzimit Nr. 5627 datë 18.11.2016 të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor “ të ndryshuar, në nenin 4 të tij , kriteret bazë të licensimit janë :

- a) reputacioni i mirë;
- b) qëndrueshmërinë e duhur financiare;
- c) kompetencën profesionale;
- d) një vendosjeje efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri.

a. Reputacioni i mirë.

Ndërmarrja, që kërkon të ushtrojë veprimtarinë e saj në transportin rrugor, dhe personat që janë caktuar në drejtimin e veprimtarisë së këtyre ndërmarrjeve, duhet të deklarojnë në dokumentet e lëshuara, nga organet e transportit, se plotësojnë kushtin e reputacionit të mirë.

Kërkesa për reputacion të mirë plotësohet në rast se personi fizik ose personat që menaxhojnë efektivisht aktivitetin :

- nuk janë shpallur fajtorë për krime ose shkelje serioze ligjore, përfshirë edhe krime ose shkelje të natyrës tregtare;
- nuk janë deklaruar të papërshtatshëm për të ushtruar veprimtarinë e operatorit të transportit sipas legjislacionit në fuqi;
- nuk janë shpallur fajtorë për shkelje serioze të ligjit të punës, legjislacionit të transportit, për shkelje të rregullave lidhur me kohën e drejtimit dhe pushimit për drejtuesin e mjetit, instalimin dhe përdorimin e paisjeve regjistruese, ose për legjislacionin lidhur me trafikun rrugor, sigurinë e mjetit dhe në mbrojtjen e mjedisit.

Për plotësimin e këtij kriteri subjektet duhet të dorëzojnë dokumenta si më poshtë:

1. Ekstraktin e regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit nga Q.K.R.
2. Dëshmi penaliteti për personin ose personat që menaxhojnë efektivisht aktivitetin.
3. Vërtetim nga gjykata dhe prokurorira për personin ose personat që menaxhojnë efektivisht aktivitetin, subjekti nuk ka proces gjyqësor lidhur me aktivitetin;
4. Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore.

b. Gjendja e përshtatshme financiare.

Kërkesa për gjendje të përshtatshme financiare plotësohet kur disponohen burime të mjaftueshme financiare, të cilat garantojnë ecurinë dhe administrimin te shoqërisë së transportit. Vlerësimi i gjëndjes financiare duhet të jetë i barabartë ose që kapërcen shumën e përgjithshme të: 140 000 lekë për mjetin e parë dhe 70 000 lekë për çdo mjet shtesë, kur kryen transport të mallrave dhe të udhëtarëve brenda vendit.

Për plotësimin e këtij kriteri si dokument provues subjektet duhet të dorëzojnë një vërtetim që mund të jetë një garanci bankare ose një siguracion në masën e caktuar më sipër.

c. Kompetenca profesionale.

Kërkesa në lidhje me kompetencën profesionale, plotësohet kur drejtuesi i veprimtarisë është i pajisur me certifikatë përkatëse të kompetencës profesionale për transport të udhëtarëve (ÇKP)

Si dokument provues duhet të paraqesin certifikatën për zotërimin e kompetencës profesionale në transportin e udhëtarëve për drejtuesin e veprimtarisë.

d. Kushtet e vendosjes efektive dhe të qëndrueshme së ndërmarrjes të transportit, plotësohen kur:

- subjekti i transportit e ka selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në ambientet, ku ajo mban dokumentet kryesore të aktivitetit ekonomik/veprimtarisë, në veçanti dokumentet e kontabilitetit, dokumentet e personelit, dokumentet që përmbajnë të dhëna në lidhje me orët e drejtuesve të mjeteve dhe dokumente të tjera. Autoriteti përgjegjës duhet të ketë akses në ambientet e ndërmarrjes, me qëllim verifikimin e përputhjes me kushtet e vendosura; (*Dokumenti provues për këtë kriter është Ekstrakti Historik e Rregjistrimit Tregëtar*)
- subjekti i transportit ka në dispozicion të tij 8 mjete, nga të cilat një mjet është rezervë;

Subjekti i transportit plotëson kërkesat ligjore në lidhje me standardet për drejtuesin e mjetit dhe mjetet, si instalimi dhe përdorimi i pajisjes për kufizim të shpejtësisë për disa kategori të mjeteve motorike.

Transporti qytetës do të ofrohet në 4 linja me itinerare, stacione dhe frekuencë si më poshtë:

Linja Bankë. Nisja në lindje të rrethrotullimit të Varrezave Publike. Kryqezimi Kristaq Sotiri – Asim Vokshi; Kryqezimi Sotir Polena – Asim Vokshi; Birra Korça; Spitali, Stacion në Bulevardin “Fan Noli” në krah të Bustit Naum Veqilarxhi; Përballë Poliklinikës; Pazari; BKT; Lëndina e Lotëve; Universiteti; Parku (Këndi i Lojrave); Sigurimet Shoqërore; Lagjia 18 (tek UKKO); Stacioni në unazë në hyrje të Rrugës “Sotir Kozmo”; Përballë kryqëzimit të Rrugës “Pano Xhamballo” me Unazën; Nënstacioni elektrik; Stacioni tek Terminali; Tek City-Center; Pazari; Poliklinika; Posta1; Shkolla Demokracia (Rruga. Partizani).

Orari 06:00 – 20:00 për 1 prill deri 30 shtator dhe 06:00-18:00 për muajt 1 tetor – 31 Mars.

Frekuenca: Çdo 23 min.

Linja Unazë. Nisja në lindje të rrethrotullimit të Varrezave Publike; Kryqezimi Kristaq Sotiri – Asim Vokshi; Kryqezimi Sotir Polena – Asim Vokshi; Birra Korça; Spitali; Në krah të Bustit Naum Veqilarxhi; Përballë Poliklinikës; Pazari; Tek City-Center; Përball Terminalit, Nënstacioni elektrik; Kryqezimit të Rrugës “Pano Xhamballo”; Shkolla e Maltës; Parku (Këndi i Lojrave); Sigurimet Shoqërore; Lagjia 18 tek (UKKO); Përballë DPM; Stacioni tek Rruga “Niko Kovaçi”; Lëndina e Lotëve; Stacioni të Bulevardi “Gjergj Kastrioti”; Pazari; Poliklinika; Posta1; Shkolla Demokracia(Rruga Partizani).

Orari 06:00 – 20:00 për 1 prill deri 30 shtator dhe 06:00-18:00 për muajt 1 tetor – 31 Mars.

Frekuenca: Çdo 24 min.

Linja Medrese – SMT - ÇIFLIG. Nisja Shkolla “Demokracia”; Tek ish Formula 1; Medrese; Dyqanet e Gurta; Pazari; City Center; Përballë Terminalit; Fabrika Tona Co; Stacioni SMT; Çiflig (me orar të reduktuar); Ish Frigoriferi; Terminali; City Center; Pazari; Përballë Dyqaneve të Gurta; Përballë Medresesë; Pranë kryqezimit me Rrugën “10 Korriku”.

Shërbimi me dy mjete. Orari 06:45 – 17:00 për periudhën 1 prill - 30 shtator dhe 06:45 - 16:00 për muajt 1 tetor - 31 Mars.

Frekuenca çdo 25 min.

Linja Korçë – Dishnicë – Neviçisht – Belorta - Kuçi Zi. Nisja Tregu Maqedonas; Përballë Terminalit; Unaze; Rruga e Barçit; Stacioni tek Sallameri Fix; Dogana Korçë; Stacion në hyrje të fshatit Dishnicë; Qëndër Dishnicë, Stacion në dalje të fshatit Dishnicë; Hyrje Neviçisht; Hyrje Belorta; Hyrje Kuç; Belorta; Neviçisht; Dishnicë; Dogana Korçë; Përballë Sallameri Fix; Përballë Rrugës të Barçit; Terminali; Tregu Maqedonas.

Shërbimi me një mjet 07:15 – 15:00 gjatë gjithë vitit.

Frekuenca çdo 1 orë.

Kriteret e përmendura më sipër janë kriteret ligjore që duhen për kualifikimin e subjekteve pjesëmarrëse.

Përveç kriterëve ligjore të sipërpërmenduar propozojmë që subjektet pjesëmarrëse në konkurs të përmbushin edhe këto kriterë:

1. Për mjetet e Transportit Qytetas me kushte komoditeti, viti i prodhimit të tyre të jetë prej vitit 2000 dhe në vazhdim, nga aplikimi për çertifikim dhe duhet ti përshtatet parametrave dhe përcaktimeve të çdo linjë. Përfshijmë nga ky rregull bën vetëm mjeti reserve.
2. Transporti qytetës mund të bëhet vetëm me mjete të destinuar për transport udhëtarësh, me numër vendesh ulur dhe në këmbë të përshtatshme për transport qytetës.
3. 100 % e flotës së mjeteve të Transportit Qytetas do të jenë të pajisura me kondicionim të ajrit, si më poshtë:
 - a. Për ngrohje brenda mjetit në temperaturë 22 gradë celsius;
 - b. Për ftohje brenda mjetit në temperaturë mbi 22 gradë celsius;
 - c. Ndërmjet temperaturave 15 dhe 22 gradë celsius, përdoret ventilimi i ajrit
4. Dyshemeja, tavani dhe paretet anësore të flotës së mjeteve të jenë të veshura, në gjendje të mirë për të siguruar hermeticitetin e nevojshëm nga faktorët e jashtëm dhe për të garantuar siguri në udhëtim.
5. Flota e mjeteve të Transportit Qytetas të jetë e pajisur me sistemet e mbrojtjes nga zjarri, me kutinë e ndihmës së shpejtë, me dritare emergjence funksionale. Pozicioni dhe mënyra e përdorimit të tyre u bëhet e njohur udhëtarëve, nëpërmjet mbishkrimeve mbi to.
6. Dyert e shërbimit të jenë me hapje të komanduar nga shoferi në mënyrë automatike.

7. Në mjetet me dy dyer duhet të jenë të shënuara mbishkrimet e orientimit “Hyrje” dhe “Dalje”. Në rastet kur mjetet kanë tre dyer, mbishkrimi “Hyrje” do të jetë në derën e parë, ndërsa mbishkrimi “Dalje” do të jetë në dy dyert e tjera.
8. Estetika e brendshme (lidhur me vendet e pasagjerëve, dritaret, dyshemetë e mjeteve etj.), që konsiston në drejtim të një paraqitjeje dhe mirëmbajtjeje sa më të pranueshme e cila respekton në këtë mënyrë kërkesat e komunitetit për një shërbim të një cilësie të lartë, do të jetë e detyrueshme për të gjitha mjetet.
9. Dritaret duhet të jenë funksionale dhe të mos zihen nga reklama pa miratimin me shkrim të Bashkisë Korçë
10. Ngjyra e mjeteve në të gjitha linjat duhet të jetë uniforme.
11. Mjetet të jenë të pajisura me pajisje të veçanta për invalidët, përveç rasteve kur infrastruktura rrugore nuk lejon përdorimin e mjeteve të këtyre standardeve, sipas përcaktimeve specifike të çdo linje.
12. Mjetet e Transportit Qytetas janë të pajisur me emrin e linjës, numrin, dokumentacionin e nevojshëm në mjet dhe shenjat e tjera të identifikimit sipas akteve të nxjerra nga organet e Bashkisë.
13. Personeli i mjeteve të Transportit Qytetas është i pajisur me uniformën, elementët e identifikimit përkatëse etj.
14. Subjekti fitues duhet të lejojë Bashkinë Korçë që në çdo mjet të instalojë sistemin e njohjes së vendodhjes së mjetit (GPS) që do të mundësojë përcaktimin elektronik të: Numrit të mjeteve në shërbim; Shpejtësinë e lëvizjes; Vendodhjen; Km e përshkruara.
15. Në momentin e finalizimit të akteve ligjore dhe nënligjore për sistemin e biletës elektronike, operatori duhet të pajisë Mjetet e Transportit Qytetas me sisteme që mundësojnë përdorimin e biletës elektronike sipas përcaktimeve në akteve ligjore të nxjerra nga organet e Bashkisë dhe kontratave të veçanta për keto sisteme të lidhura midis Bashkisë dhe operatorëve të transportit qytetës për këto sisteme.
16. Mjetet e Transportit Qytetas të janë të pastëra (si nga jashtë dhe nga brenda) dhe të kenë informacionet e nevojshme për publikun (sipas përcaktimeve në rregulloren tip të udhëtimit)
17. Subjekte pjesëmarrëse në konkurim duhet të kenë një numër të punësuarish prej të paktën 22 punonjës, nga të cilër 11 të jenë shoferë dhe 11 fatorino.
18. Subjekte pjesëmarrëse në konkurim duhet të kenë në pronësi dhe/ose përdorim një sipërfaqe për parkimin e automjeteve prej të paktën 800 m²

Propozojmë që kontrata do të lidhet me një afat 3 vjeçar.

Bashkia Korçë do të subvencionojë subjektin fitues sipas parashikimeve në buxhetin vjetor të Bashkisë. Për vitin 2023 masa e subvencionimit e përcaktuar me VKB 183 datë 28.12.2022 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë” është në masën 10 000 000 lekë .

Subvencionimi të përdoret për udhëtimin falas në shërbimin e transportit urban për pensionistët. Bazuar në kriteret e propozuara dhe sa u parashtrua për miratim, ekzekutivi kryejë përzgjedhjen e subjektit të transportit nëpërmjet konkurimit të hapur, duke lidhur më pas kontratën. Njoftimi i datës së konkurimit, kriterëve dhe i dokumentave që duhet të paraqesin konkurrentët të kryhet nëpërmjet publikimit në media dhe në stendën e lajmërimeve të Bashkisë Korçë . Data e zhvillimit të konkurimit të jetë 15-ditë pas publikimit të njoftimit.

**Drejtores e Përgjithshme Juridike
dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore**

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)

**Drejtores e Përgjithshme e Financës,
Buxhetit dhe MFK**

Valbona Ziko

**Për Drejtorinë e Menaxhimit të Kontratave
Leonard Gjançi**

**Drejtoria e Kontrollit të Territorit
Lorenc Palodhi**

**KRYETARI
SOTIRAQ FILO**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE**

P/VENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2023

PËR

**“MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN NËPËRMJET
KONKURRIMIT TË SUBJEKTIT QË DO TË KRYEJE TRANSPORTIN QYTETËS
(URBAN), ME SUBVENCION”**

Këshilli Bashkiak i mbledhur sot ,pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga ekzekutivi si dhe bazuar në nenin 23 pika 6 dhe 54 gërma k të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, në nenin 14 të ligjit Nr. 8308 datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” të ndryshuar, VKM Nr. 325 dt 19.03.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve si dhe për njohjen e dokumentave zyrtarë të caktuara për këta operatorë” I ndryshuar, Udhëzimi Nr. 5627 datë 18.11.2016 të Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor “ të ndryshuar, VKB 183 datë 28.12.2022 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Korçë” si dhe dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI

1. Të miratojë kriteret e nevojshme mbi bazën e të cilave do të kryhet përzgjedhja e shoqërisë që do të kryejë shërbimin e transportit qytetës dhe si më poshtë:

- Për mjetet e Transportit Qytetas me kushte komoditeti, viti i prodhimit të tyre të jetë prej vitit 2000 dhe në vazhdim, nga aplikimi për çertifikim dhe duhet ti përshtatet parametrave dhe përcaktimeve të çdo linje. Përjashtim nga ky rregull bën vetëm mjete reserve.
- Transporti qytetës mund të bëhet vetëm me mjete të destinuara për transport udhëtarësh;
- 100 % e flotës së mjeteve Transportit Qytetas do të jenë të pajisura me kondicionim të ajrit, si më poshtë:

- Për ngrohje brenda mjetit në temperaturë 22 gradë celsius;
 - Për ftohje brenda mjetit në temperaturë mbi 22 gradë celsius;
 - Ndërmjet temperaturave 15 dhe 22 gradë celsius, përdoret ventilimi i ajrit
- Dyshemeja, tavani dhe paretet anësore të flotës së mjeteve të jenë të veshura, në gjendje të mirë për të siguruar hermeticitetin e nevojshëm nga faktorët e jashtëm dhe për të garantuar siguri në udhëtim.
 - Flota e mjeteve të Transportit Qytetas të jetë e pajisur me sistemet e mbrojtjes nga zjarri, me kutinë e ndihmës së shpejtë, me dritare emergjence funksionale. Pozicioni dhe mënyra e përdorimit të tyre u bëhet e njohur udhëtarëve, nëpërmjet mbishkrimeve mbi to.
 - Dyert e shërbimit të jenë me hapje të komanduar nga shoferi në mënyrë automatike.
 - Autobuzat duhet të jenë të përshtatshëm me rampa për hipjen dhe zbritjen e invalidëve, të moshuarve dhe për gra shtatzëna.
 - Në mjetet me dy dyer duhet të jenë të shënuara mbishkrimet e orientimit “Hyrje” dhe “Dalje”. Në rastet kur mjetet kanë tre dyer, mbishkrimi “Hyrje” do të jetë në derën e parë, ndërsa mbishkrimi “Dalje” do të jetë në dy dyert e tjera.
 - Estetika e brendshme (lidhur me vendet e pasagjerëve, dritaret, dyshemetë e mjeteve etj.), që konsiston në drejtim të një paraqitjeje dhe mirëmbajtjeje sa më të pranueshme e cila respekton në këtë mënyrë kërkesat e komunitetit për një shërbim të një cilësie të lartë, do të jetë e detyrueshme për të gjitha mjetet.
 - Dritaret duhet të jenë funksionale dhe të mos zihen nga reklama pa miratimin me shkrim të Bashkisë Korçë.
 - Ngjyra e mjeteve në të gjitha linjat duhet të jetë uniforme.
 - Mjetet të jenë të pajisura me pajisje të veçanta për invalidët, përveç rasteve kur infrastruktura rrugore nuk lejon përdorimin e mjeteve të këtyre standardeve, sipas përcaktimeve specifike të çdo linje.
 - Mjetet e Transportit Qytetas janë të pajisur me emrin e linjës, numrin, dokumentacionin e nevojshëm në mjet dhe shenjat e tjera të identifikimit sipas akteve të nxjerra nga organet e Bashkisë.
 - Personeli i mjeteve të Transportit Qytetas është i pajisur me uniformën, elementët e identifikimit përkatëse etj.
 - Subjekti fitues duhet të lejojë Bashkinë Korçë që në çdo mjet të instalojë sistemin e njohjes së vendodhjes së mjetit (GPS) që do të mundësojë përcaktimin elektronik

të: Numrit të mjeteve në shërbim; Shpejtësinë e lëvizjes; Vendodhjen; Km e përshkruara.

- Në momentin e finalizimit të akteve ligjore dhe nënligjore për sistemin e biletës elektronike, operatori duhet të pajisë Mjetet e Transportit Qytetas me sisteme që mundësojnë përdorimin e biletës elektronike sipas përcaktimeve në akteve ligjore të nxjerra nga organet e Bashkisë dhe kontratave të veçanta për keto sisteme të lidhura midis Bashkisë dhe operatorëve të transportit qytetës për këto sisteme.
- Mjetet e Transportit Qytetas të janë të pastëra (si nga jashtë dhe nga brenda) dhe të kenë informacionet e nevojshme për publikun (sipas përcaktimeve në rregulloren tip të udhëtimit)
- Subjekte pjesëmarrëse në konkurim duhet të kenë një numër të punësuarish prej të paktën 22 punonjës, nga të cilër 11 të jenë shoferë dhe 11 faktorino.
- Subjekte pjesëmarrëse në konkurim duhet të kenë në pronësi dhe/ose përdorim një sipërfaqe për parkimin e automjeteve prej të paktën 800 m²

2. Kriteret e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi janë kritere skualifikuese.

Mosplotësimi i tyre passjell skualifikim e subjekteve pjesëmarrëse në konkurs.

3. Kriteret që do të vlerësohen me pikë janë si më poshtë:

A. Viti i prodhimit të automjetit. Në konkurim do të pranohen vetëm subjektet të cilat kanë në pronësi dhe /ose përdorim automjete të prodhuara gjatë ose pas vitit 2000.

Me vit prodhimi 2000 – 2005 = 15 pikë.

Me vit prodhimi 2006 – 2010 = 20 pikë.

Me vit prodhimi 2011 e në vazhdim = 25 pikë

B. Numri i autobusëve që do të përdoren në linjë.

Numri minimal i autobusëve që duhet të ketë një subjekt për të qënë pjesëmarrës në konkursin për transportin qytetës të jetë 8 nga të cilat një mjet është rezervë. Për çdo autobus shtesë subjekteve pjesëmarrëse në konkurs t'i jepen 30 pikë.

C. Numri i viteve që subjekti ka ushtruar veprimtarinë në transportin e udhëtarëve me autobusë.

Subjekti përfiton 10 pikë për çdo vit gjatë të cilit ka ushtruar këtë aktivitet.

D. Numri i të punësuarve

Subjektet pjesëmarrëse në konkurim të kenë një numër të punësuarish prej të paktën 22 punonjës, nga të cilër 11 të jenë shoferë dhe 11 faktorino. Për çdo të punësuar shtesë subjekteve

pjesëmarëse në konkurs t'i jepen 30 pikë. (Për plotësimin e këtij kriteri subjekti duhet të paraqesë lispagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore)

4. Kontrata të lidhet me afat 3 vjeçar.
5. Bashkia Korçë të subvencionojë subjektin fitues sipas parashikimeve në buxhetin vjetor të Bashkisë. Subvencionimi të përdoret për udhëtimin falas në shërbimin e transportit urban për pensionistët.
6. Sipas kriterëve të përcaktuara të kryet përzgjedhja e subjektit të transportit, nëpërmjet konkursit të hapur.
7. Njoftimi i datës se konkurrimit, kriterëve dhe i dokumentave që duhet të paraqesin konkurrentet të kryhet nëpërmjet publikimit në media dhe në stendën e lajmërimeve të Bashkisë Korçë .
8. Data e zhvillimit të konkurrimit të jetë 15-ditë pas datës të publikimit të njoftimit.
9. Transporti qytetës do të ofrohet në 4 linjat e miratuara me vendim këshilli, me itinerare, stacione dhe frekuencë si më poshtë:

Linja Bankë. Nisja në lindje të rrethrotullimit të Varrezave Publike. Kryqezimi Kristaq Sotiri – Asim Vokshi; Kryqezimi Sotir Polena – Asim Vokshi; Birra Korça; Spitali, Stacion në Bulevardin “Fan Noli” në krah të Bustit Naum Veqilarxhi; Përballë Poliklinikës; Pazari; BKT; Lëndina e Lotëve; Universiteti; Parku (Këndi i Lojgrave); Sigurimet Shoqërore; Lagjia 18 (tek UKKO); Stacioni në unazë në hyrje të Rrugës “Sotir Kozmo”; Përballë kryqëzimit të Rrugës “Pano Xhamballo” me Unazën; Nënstacioni elektrik; Stacioni tek Terminali; Tek City-Center; Pazari; Poliklinika; Posta1; Shkolla Demokracia (Rruga. Partizani).

Orari 06:00 – 20:00 për 1 prill deri 30 shtator dhe 06:00-18:00 për muajt 1 tetor – 31 Mars.

Frekuenca: Çdo 23 min.

Linja Unazë. Nisja në lindje të rrethrotullimit të Varrezave Publike; Kryqëzimi Kristaq Sotiri – Asim Vokshi; Kryqezimi Sotir Polena – Asim Vokshi; Birra Korça; Spitali; Në krah të Bustit Naum Veqilarxhi; Përballë Poliklinikës; Pazari; Tek City-Center; Përballë Terminalit, Nënstacioni elektrik; Kryqezimit të Rrugës “Pano Xhamballo”; Shkolla e Maltës; Parku (Këndi i Lojgrave); Sigurimet Shoqërore; Lagjia 18 tek (UKKO); Përballë DPM; Stacioni tek Rrugës “Niko Kovaçi”; Lëndina e Lotëve; Stacioni të Bulevardi “Gjergj Kastrioti”; Pazari; Poliklinika; Posta1; Shkolla Demokracia(Rruga Partizani).

Orari 06:00 – 20:00 për 1 prill deri 30 shtator dhe 06:00-18:00 për muajt 1 tetor – 31 Mars.

Frekuenca: Çdo 24 min.

Linja Medrese – SMT - ÇIFLIG. Nisja Shkolla “Demokracia”; Tek ish Formula 1; Medrese; Dyqanet e Gurta; Pazari; City Center; Përballë Terminalit; Fabrika Tona Co; Stacioni SMT; Çiflig (me orar të reduktuar); Ish Frigoriferi; Terminali; City Center; Pazari; Përballë Dyqaneve të Gurta; Përballë Medresesë; Pranë kryqëzimit me Rrugën “10 Korriku”.

Shërbimi me dy mjete. Orari 06:45 – 17:00 për periudhën 1 prill - 30 shtator dhe 06:45 - 16:00 për muajt 1 tetor - 31 Mars.

Frekuenca çdo 25 min.

Linja Korçë – Dishnicë – Neviçisht – Belorta - Kuçi Zi. Nisja Tregu Maqedonas; Përballë Terminalit; Unaze; Rruga e Barçit; Stacioni tek Sallameri Fix; Dogana Korçë; Stacion në hyrje të fshatit Dishnicë; Qëndër Dishnicë, Stacion në dalje të fshatit Dishnicë; Hyrje Neviçisht; Hyrje Belorta; Hyrje Kuç; Belorta; Neviçisht; Dishnicë; Dogana Korçë; Përballë Sallameri Fix; Përballë Rrugës të Barçit; Terminali; Tregu Maqedonas.

Shërbimi me një mjet 07:15 – 15:00 gjatë gjithë vitit.

Frekuenca çdo 1 orë.

10. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe MFK, Drejtoria e Kontrollit të Territorit dhe Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave.

11. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

K R Y E T A R
ERJON NEXHIPI

Miratuar me _____vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____